DEKRET
Nr.266, datë 22.7.1992

PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese" me propozim të Këshillit të Ministrave

DEKRETOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Buxheti i shtetit është programi financiar vjetor, që përfshin të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e shtetit dhe që përbëhet nga buxheti kombëtar, buxhetet lokale, buxheti i sigurimeve shoqërore dhe bixheti i asistencës sociale. Buxheti i shtetit hartohet dhe miratohet mee ligj, si rregull, për një periudhë njëvjeçare.

Neni 2

Buxheti i shtetit përfshin krijimin idhe përdorimin e të gjitha fondeve financiare shtetërore në buxhetin e shtetit, me përjashtim të rasteve të parashikuara me dispozita ligjore të veçanta. Në këto raste fondet financiare speciale përbëjnë anekse shtesë të buxhetit të shtetit dhe u nënshtrohen dispozitave të këtij ligji.

Neni 3

Buxheti kombëtar përfshin të ardhurat që me ligj derdhen në buxhetin e shtetit, dhe shpenzimet e administratës shtetërore qendrore e të institucioneve të saj. Buxhetet lokale përfshijnë të ardhurat që me ligj u lihen atyre, dhe shpenzimet e administratës shtetërore lokale e të institucioneve të saj.

Buxheti i sigurimeve shoqërore shtetërore përfshin të ardhurat dhe shpenzimet për sigurimet e detyrueshme. Buxheti i asistencës sociale përfshin të ardhurat dhe shpenzimet për mbrojtjen sociale të shtresave të popullsisë të njohura me ligj.

Neni 4

Viti buxhetor fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti kalendarik.

Neni 5

Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë siguron kontroll mbi gjithë procesin e hartimit, të miratimit e të zbatimit të buxhetit të shtetit dhe përcakton për çdo vit nivelin e shpenzimeve buxhetore dhe rradhën e përparësive të politikës buxhetore të vendit.

Neni 6

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë bën klasifikimin buxhetor të të ardhurave e të shpenzimeve të të gjitha hallkave të buxhetit të shtetit, duke i ndarë ato në tituj, kapituj dhe artikuj. Ajo cakton gjithashtu rregullat dhe mënyrat e derdhjes së të ardhurave në buxhetet e ndryshme, rregullat e financimit e të përdorimit të fondeve buxhetore, të drejtat dhe detyrat e urdhëruesve buxhetorë si dhe rregullat e kontrollit e të raportimit buxhetor.

Neni 7

Administratorët e fondeve buxhetore ndahen në urdhërues kryesorë, në urdhërues të shkallës së dytë dhe urdhërues të shkallës së tretë. Urdhërues kryesorë janë titullarët e ministrive e institucioneve të tjera qendrore ekuivalentë me ta, si dhe titullarët e administratës shtetërore lokale ose personat e autoriuar prej tyre. Urdhërues të shkallës së dytë e të tretë janë, sipas rastit, drejtues të institucioneve shtetërore në vartësi të administratës shtetërore qëndrore e lokale.

Neni 8

Të ardhurat e buxhetit të shtetit formohen nga të ardhurat e akcizave, të tatimit mbi qarkullimin, të tatimeve të tjera të tërthorta, të taksave doganore, të llojeve të ndryshme të tatimeve të drejtpërdrejta, si tatimi mbi fitimin, të llojeve të ndryshme të taksave kombëtare e lokale e të ardhurave të tjera shtetërore që rregullohen me ligj.

Neni 9

Të ardhurat e buxhetit të shtetit, realizohen sipas vendndodhjes territoriale të personave juridikë e fizikë pagatorë të tyre.

Neni 10

Në shpenzimet e buxhetit të shtetit përfshihen shpenzimet për arsimin, shëndetësinë, kulturën sociale dhe sigurimet shoqërore, shpenzimet për investimet, për mbajtjen e aparatit shtetëror, për mbrojtjen dhe shpenzimet e tjera që përcaktohen me ligj.

Neni 11

Llojet e të ardhurave që derdhen në secilën hallkë të buxhetit, dhe llojet e shpenimeeve që financohen prej secilës hallkë të buxhetit të shtetit, caktohen me dispozita të veçanta. Me dispozita të veçanta rregullohen edhe marrëdhëniet ndërmjet hallkave të veçanta të buxhetit të shtetit.

KREU II
HARTIMI DHE MIRATIMI I BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 12

Buxheti i shtetit hartohet nga Minsitria e Financave dhe e Ekonomisë, në bazë të objektivave ekonomiko-financiare të vendosur nga Kuvendi Popullor dhe Këshilli i Ministrave, të analizës e të studimeve të saj dhe projekteve të paraqitura për këtë qëllim nga ministritë e institucionet e tjera qendrore, nga organet e administratës lokale, nga institucionet e sigurimeve shoqërore shtetërore dhe ato të mbrojtjes sociale të popullsisë. Për realizimin e kësaj të gjitha njësitë ekonomike dhe institucionet janë të detyruara të paraqesin sipas shkallës së vartësisë treguesit ekonomikë e financiarë për vitin parashikues.

Neni 13

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet e tjera qëndrore dhe me organet e pushtetit lokal, paraqet në Keshillin e Ministrave brenda datës 15 tetor të çdo viti kufijtë maksimalë të shpenzimeve shtetërore dhe të ardhurat e buxhetit të shtetit për vitin e ardhshëm buxhetor, vlerësimin e saj në lidhje me plotësimin e të ardhurave për të njëjtën periudhë, si dhe objektivat e politikës fiskale për vitin e ardhshëm. Këto, pasi shqyrtohen nga Këshilli i Ministrave, miratohen prej tij dhe, jo më vonë se fundi i muajit tetor, i paraqiten Kuvendit Popullor.

Neni 14

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë nxjerr udhëzime dhe pregatit materiale të tjera të nevojshme për hartimin e projektbuxhetit të shtetit, drejton procesin e hartimit të këtij buxheti dhe kontrollon punën e të gjithë organeve të adminisrtatës shtetërore në këtë fushë.

Neni 15

Projektbuxheti i shtetit që paraqitet për shqyrtim e miratim, duhet të përmbajë:

a) Të ardhurat e çdo hallke të buxhetit të shtetit me çmime korrente të ndara sipas burimeve kryesore të fitimit të tyre.

b) Shpenzimet e çdo hallke të buxhetit të shtetit me çmime korrente të ndara sipas llojeve të tyre dhe sipas qëllimit e funksioneve të organeve e institucioneve shtetërore qëndrore e lokale.

c) Shpenzimet shtetërore të vitit buxhetor në vazhdim dhe të dy vjetëve të ardhshëm, vlerësuar me çmimet e krahasueshme.

ç) Të ardhurat e vitit buxhetor në vazhdim dhe të dy vjetëve të ardhshëm, vlerësuar me çmime të krahasueshme.

d) Propozimet për rritjen e mundshme të të ardhurave reale buxhetore.

dh) Të ardhurat dhe shpenzimet faktike të buxhetit të shtetit për vitin e kaluar.

e) Tepricën e gjendjes së të ardhurave buxhetore të disponueshme në fund të vitit të kaluar dhe të vitit në vazhdim.

ë) Tepricën e gjendjes së të ardhurave buxhetore të disponueshme në fund të vitit, për të cilën paraqitet buxheti.

f) Një informacion për gjendjen dhe problemet e buxhetit shtetëror.

g) Madhësinë e deficitit ose të sificitit buxhetor dhe mënyrat e rregullimit të tyre.

gj) Kufijtë maksimale të numrit të përgjithshëm të punonjësve e të administratës që financohet nga buxheti i shtetit, si dhe numrin e njerëzve që ka të drejtë të punësosjë qeveria.

h) Shumën e rezervës buxhetore për përballimin e shpenzimeve të paparashikuara në vitin, për të cilin miratohet buxheti.

Neni 16

Çdo ministri, institucion qëndror dhe organ i administratës lokale detyrohet të paraqesë në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë brenda datës 15 shtator të çdo viti projektbuxhetin e të ardhurave e të shpenzimeve të veta për vitin e ardhshëm buxhetor. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka të drejtë të kërkojë nga ministritë, institucionet qëndrore dhe organet e administratës çdo informacion të nevojshëm për hartimin e projektbuxhetit të shtetit, si dhe të ushtrojë kontroll për saktësinë dhe plotësimin e tyre.

Neni 17

Projektbuxheti i sigurimeve shoqërore shtetërore dhe ai i asistencës sociale hartohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore e Shtetërore dhe Ministria e Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë dhe paraqitet në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë brenda datës 15 shtator të çdo viti. Kur buxheti i sigurimeve shoqërore shtetërore dhe i asistencës sociale paraqiten me deficit dhe nuk gjenden mënyra të tjera për balancimin e tyre, me miratim të Kuvendit Populllor, subvencionohet nga buxheti kombëtar.

Neni 18

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka të drejtë të parashikojë në buxhetin kombëtar një fond rezervë në masën 2 për qind të shumës totale të shpenzimeve të miratuara. Në buxhetin lokal këtë të drejtë e ka administrata lokale. Ky fond rezervë përdoret, sipas rastit me vendim të Këshillit të Ministrave ose organit të zgjedhur të administratës lokale, për përballimin e shpenzimeve buxhetore të paparashikuara në momentin e miratimit të buxhetit.

Neni 19

Projektbuxheti shqyrtohet dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave brenda kufijve të përmendura në nenin 13 të këtij ligji dhe pastaj paraqitet për shqyrtim e miratim në Kuvendin Populllor, së bashku me materialet e nevojshme shoqëruese, brenda datës 30 nëntor të çdo viti.

Neni 20

Në rastet kur gjer më 1 janar të vitit buxhetor Kuvendi Populllor nuk miraton buxhetin e shtetit, Këshilli i Ministrave vendos për financimin e shpenimeve për një periudhë deri në 3 muaj. Me kalimin e këtij afati kryerja e shpenzimeve bëhet me dekret të veçantë të Presidentit të Republikës. Kur nxjerrja e vendimit të Këshillit të Ministrave dhe e dekretit të Presidentit të Republikës vonojnë në kohë, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka të drejtë deri në 1 muaj të çelë fonde për shpenzimet më të domosdoshme.

Neni 21

Pas miratimit të buxhetit të shtetit në Kuvendin Populllor, të gjitha kërkesat e urdheruesve kryesorë për fonde suplementare buxhetore, si dhe ato kërkesa që kanë të bëjnë me ndryshimin e politikave të veçanta ekonomike e financiare dhe që prekin objektivat e politikës fiskale të vitit buxhetor, i paraqiten Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë. Kjo e fundit, pasi i shqyrton i përcjell në Këshillin e Ministrave për shqyrtim e miratim. Pas kësaj Këshilli i Ministrave i përcjell ato për miratim përfundimtar në Kuvendin Populllor.

Neni 22

Çdo njësi administrative lokale ka buxhetin e vet. Projektbuxhetet lokale hartohen nga seksionet e financave të organeve administrative lokale në bazë të legjislacionit në fuqi, të udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, të vendimeve të organeve lokale të zgjedhura dhe të materialeve të institucioneve vartëse të organeve lokale.

Neni 23

Projektbuxhetet lokale shqyrtohen nga organet e zgjedhura lokale dhe brenda datës 15 shtator të çdo viti paraqiten në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë. Miratimi përfundimtar i buxheteve lokale bëhet nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, jo më vonë se 15 ditë pasi të jetë miratuar buxheti i shtetit nga Kuvendi Populllor.

KREU III
ZBATIMI I BUXHETIT TË SHTETIT

Neni 24

Zbatimi i buxhetit të shtetit kryhet nga organet e Ministrisë së Financavee dhe Ekonomisë, nga urdhëruesit buxhetorë të kategorive të ndryshmee dhe nga Banka e Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë ngarkohet të kryejë të gjitha veprimet e arkës së buxhetit të shtetit, arkëtimin e të gjitha llojeve të të ardhurave të buxhetit, pagesën e të gjitha llojeve të shpenzimeve buxhetore, si dhe evidencimin e gjendjes e të lëvizjes së fondeve buxhtore.

Neni 25

Mbikëqyrja e përgjithshme e zbatimit të buxhetit të shtetit ushtrohet nga Këshilli i Ministrave dhe nga organet e zgjedhura të adminisrtatës shtetërore lokale.

Neni 26

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ngarkohet me nxjerrjen e rregullave e të udhëzimeve për veprimet e zbatimit të buxhetit të shtetit, për të drejtat e deetyrat e hallkave të ndryshme të aparatit shtetëror qëndror dhe lokal në lidhje me zbatimin e buxhetit dhe me analizën e punës operative të këture organeve për ndjekjen e edetyrave të zbatimit të buxhetit të shtetit.

Neni 27

Me qëllim që të ruhet një ekuilibër ndërmjet realizimit të të ardhurave të buxhetit të shtetit dhe kryerjes së shpenzimeve buxhetore gjatë vitit buxhetor, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka të drejtë të ndajë e të rindajë fondet buxhetore në afatet kohore brenda vitit buxhetor. Kjo ndarje bëhet edhe sipas funksioneve dhe objekteve të shpenzimeve. Gjatë kryerjes së ndarjes dhe rindarjes si më sipër të fondeve buxhetore, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka të drejtë të mbajë një rezervë deri në 1 për qind të çdo fondi buxhetor për përballimin e rasteve të paparashikuara.

Neni 28

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë bën çeljen e fondeve buxhetore për urdhëruesit kryesorë dhe këta, nga ana e tyre, në bazë të rregullave të miratuara, çelin fondet buxhetore në dispozicion të urdhëruesve të shkallës së dytë e të shkallës së tretë. Ndryshimet në treguesit e shpenzimeve të buxhetit që lindin gjatë vitit nga marrëdhëniet ndërmjet ministrive dhe institucioneve të tjera qëndrore, si dhe ndërmjet tyre e organeve të pushtetit lokal, bëhen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë me propozimin e ministrisë a të organit të pushtetit lokal.

Neni 29

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka të drejtë të tërheqë të gjitha fondet buxhetore të çelura në zërin përkatës, në rastet e anulimit ose të shtyrjes së detyrave, për të cilat ato janë akorduar.

Kur vërehen keqpërdorime të fondeve buxhetore dhe shkelje të rregullave të administrimit të tyre, kjo ministri dhe urdhëruesit e shkallës më të lartë kanë të drejtë të marrin masa për shkelje të disiplinës buxhetore e asaj financiare sipas ligjeve në fuqi.

Neni 30

Në rastet kur nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë shihet e nevojshme që të bëhet transferimi i një pjese të fondeve nga një lloj shpenzimi në një tjetër, kjo ministri ka të drejtë të ndryshojë mundësinë individuale të miratuar të fondeve të veçanta buxhetore, por jo më shumë se 5 për qind e madhësisë së këtij fondi.

Neni 31

Gjatë zbatimit të buxhetit të shtetit Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ka të drejtë t'i propozojë KëshillitMinistrave kufizimin e shpenzimeve buxhetore të çdo fondi, me qëllim që shuma totale e tyre të mos i kalojë të ardhurat buxhetore të parashikuara për vitin në vazhdim. Çdo masë në këtë drejtim synon të ruajë realizimin e objektivave të politikës fiskale.

Neni 32

Ministria e Financave dhe e Ekonomisë mbikëqyr dhe kontrollon respektimin e numrit të personelit të miratuar, bashkë me buxhetin në të gjitha organizmat buxhetore të të gjitha niveleve.

Neni 33

Urdhëruesit e buxhetit organizojnë, mbikëqyrin dhe kontrollojnë veprimtarinë financiare të

organeve të tyre vartëse. Çdo urdhërues buxhetor detyrohet të marrë masat e nevojshme që sigurojnë plotësimin e të gjitha zërave të buxhetit të tyre. Urdhëruesit kryesorë një herë në muaj duhet t'i raportojnë Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë në një formë të caktuar për plotësimin e buxhetit të tyre, si për pjesën e të ardhurave, ashtu edhe për pjesën e shpenzimeve, së bashku me masat e marra. Ministria e Financave dhe e Ekonomisë i raporton operativisht Këshillit të Ministrave për treguesit më kryesorë plotësimin mujor të buxhetit të shtetit.

Punonjësit e ngarkuar për ndjekjen e raportimin e buxhetit respektojnë afatet e caktuara nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë. Shkelja e këtij rregulli përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 1000 lekë nga punonjësit e Drejtorisë së buxhetit në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, si dhe punonjësit e autorizuar për administrimin e buxhetit nga urdhëruesit e fondeve sipas shkallëve. Kundër vendimit të dënimit me gjobë bëhet ankim, brenda 5 ditëve nga data e dhënies së tij, përkatësisht te ministri i Financave dhe i Ekonomisë, ose te urdhëruesi i shkallës më të lartë, akti i të cilit është i formës së prerë.

KREU IV
ADMINISTRIMI I FONDEVE BUXHETORE

Neni 34

Me përjashtim të rasteve që me ligj vendoset ndryshe, nuk lejohet që mjetet buxhetore të shtetit të jepen hua, të përdoren për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë caktuar, të depozitohen në banka e institucione të tjera, jashtë llogarive të buxhetit që çelen për këtë qëllim në Bankën e Shqipërisë, ose të këmbehen me vlera të tjera. Të gjithë nëpunësit shtetërorë ose personat e autorizuar prej tyre që kryejnë arkëtime për llogari të buxhetit të shtetit, në qoftë se me ligj tjetër nuk parashikohet ndryshe, duhet t'i depozitojnë këto mjete brenda afateve të caktuara në llogaritë e buxhetit të shtetit që çelen për këtë qëllim në Bankën e Shqipërisë. Ndaj personave që shkelin këtë rregull merren masa disiplinore deri në largim nga puna dhe ngarkohen me detyrime për kohën dhe pjesën e mjeteve buxhetore që kanë mbajtur pa derdhur në llogarinë e buxhetit.

Neni 35

Ndalohet që për llogari të buxhetit të shtetit të bëhen shpenzime ose të merren përsipër detyrime financiare me një shumë më të madhe se fondet buxhetore të miratuara për qëllime dhe periudhën përkatëse. Të gjithë nëpunësit e administratës shtetërore qendrore e lokale që shkelin rregullat e mësipërme të administrimit e të përdorimit të fondeve buxhetore, dënohen me gjobë në masën deri në tri paga mujore. Gjykimi I kundërvajtjes administrative bëhet nga organet dhe sipas procedurës që përcaktohet në nenin 33 të këtij ligji.

Neni 36

Çdo fond buxhetor mund të përdoret vetëm për qëllimin e akorduar dhe për kryerjen e shpenzimeve a shlyerjen e detyrimeve që i përkasin periudhës për të cilën është dhënë. Me përjashtim të rasteve kur me ligj të posaçëm parashikohet ndryshe, të gjitha tepricat e përdorura të fondeve buxhetore kthehen dh grumbullohen në llogari përkatëse të buxhetit të shtetit pranë Bankës së Shqipërisë në afatet që përcaktohen nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 37

Nëpunësit e ngarkuar me disponimin dhe ruajtjen e fondeve buxhetore, mbajnë llogari të rregullta për to, regjistrojnë në mënyrë kronologjike e sistematike në bazë të dokumentave përkatëse, të gjitha veprimet e çeljes, të përdorimit, lëvizjes dhe mbylljes së fondeve buxhetore duke hartuar në fund të çdo periudhe kalendarike raportin sipas një forme të caktuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë.

Neni 38

Me mbarimin e vitit buxheetor të gjithë urdhëruesit e kredive buxhetore të administratës shtetërore qëndrore e lokale hartojnë sipas formës së caktuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, raportin për zbatimin e buxhetit të kompetencës së tyre dhe brenda afateve të caktuara, ua kalojnë këtë organeve eprore. Urdhëruesit kryesorë të kredive buxhetore, brenda muajit shkurt të vitit pasardhës, paraqesin në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë raportin e plotë për zbatimin e buxhetit të njësive vartëse, të shoqëruar me analizat dhe propozimet përkatëse.

Brenda muajit maj të vitit pasardhës, Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, nxjerr rezultatet e plota të zbatimit të buxhetit të shtetit të vitit të mëparshëm dhe, bashkë me analizat dhe propozimet përkatëse, i paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave.

Këshilli i Ministrave, pasi shqyrton zbatimin e buxhetit të shtetit, miraton buxhetin faktik të vitit të mëparshëm dhe, brenda muajit qershor të çdo viti, e përcjell për miratim në Kuvendin Popullor, i cili, bashkë me shqyrtimin e projektbuxhetit të vitit të ardhshëm, shqyrton e miraton edhe buxhetin faktik të vitit të mëparshëm. Buxhetet lokale faktike miratohen edhe nga organet e zgjedhura lokale në të njëjtën kohë me miratimin e projektbuxheteve të vitit të ardhshëm.

Neni 39

Gjithë veprimtaria e organeve shtetërore në lidhje me hartimin, miratimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit, si dhe çdo gjë që lidhet me sigurimin, ruajtjen e përdorimin e fondeeve buxhetore, kontrollohen nga organet e specializuara të Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë.

Neni 40

Ligji nr.6803, datë 29.6.1983 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit", dhe ligji nr.7375, datë 8.5.1990, për disa ndryshime në ligjin e mësipërm, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 41

DISPOZITA TRANZITORE

Në kushtet kur ristrukturimi i pushtetit lokal do të kërkojë një farë kohe, do të përcaktohen kompetencat e reja të komunave, bashkive e rretheve, marrëdhëniet e buxhetit kombëtar me buxhetet lokale të vazhdojnë në formën e sotme të mbulimit bruto të shpenzimeve të buxhetit lokal dhe të tërheqjes të gjithë të ardhurave në buxhetin e shtetit. Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit 1992 do të paraqitet në Këshillin e Ministrave projekti për një shtesë në ligjin e buxhetit për ndarjen e të ardhurave e të shpenzimeve buxhetore ndërmjet hallkave të buxhetit të shtetit dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Neni 42

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha